

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ADVANCED GREEN INDUSTRY PARTNERS CORPORATION” SH.P.K

Ortakët themelues:

- **Z. Oscar Bottura**
- shtetas italian, i datëlindjes 04/03/1967, lindur në Milano dhe banues në Rrugen Arcivescovo Romilli 24, Itali, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit italiane Nr. YA5395122

dhe

- **Z. Mareglen Tomori**
- shtetas shqiptar, i datëlindjes 18/09/1984, lindur në Berat, Shqipëri dhe banues në Rrugen Torino 83, Rozzano, Milano, Itali, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit italiane Nr. I40918047G

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot më datë 15.07.2023, hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

NENI 1

Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “ADVANCED GREEN INDUSTRY PARTNERS CORPORATION” SH.P.K

Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2

Forma

Shoqëria tregtare “ADVANCED GREEN INDUSTRY PARTNERS CORPORATION” SH.P.K ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1. Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “ADVANCED GREEN INDUSTRY PARTNERS CORPORATION” SH.P.K, do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Donika Kastrioti 3, Kisha Apostolike e Re, Hyrja 2, Kati i 1, Apt.1, Nr.1, Tirane, Shqipëri.

3.2. Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

- Kompania lind me njohuritë dhe përvojën shumëvjeçare të themeluesve, në rritjen e kapaciteteve të menaxhimit dhe grumbullimit të mbetjeve urbane e natyrore në tokë dhe ujë, shndërrimin e tyre në energji përmes impjanteve të modernizuara për djegie (inceneratorëve).
- Studimi i ndikimit në mjedis, këshilla ligjore, administrative dhe profesionale për palët e treta, veçanërisht në fushën e bioteknologjisë, kimisë dhe gjeologjisë, duke ofruar një shërbim 360 gradë për sigurinë mjedisore dhe parandalimin e katastrofave natyrore dhe ndotjes ambientale.

- Blerje dhe shitje të paneleve fotovoltaike dhe materialeve të tjera të fushës së energjisë natyrore dhe inovative, produkte të gjelberta eko-qendrueshme, import-eksport.
- Shërbime transporti dhe shpërndarje, logjistike brenda dhe jashtë vendit.
- Projektim, Zbatim dhe koordinim i projekteve ne fushen e siperpermendur.

NENI 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

NENI 6
Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare “ADVANCED GREEN INDUSTRY PARTNERS CORPORATION” SH.P.K mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7
Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë “ADVANCED GREEN INDUSTRY PARTNERS CORPORATION” SH.P.K, nuk mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8
Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ADVANCED GREEN INDUSTRY PARTNERS CORPORATION” SH.P.K është 200.000 (dyqind mijë) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga ortakët e ndarë në 2 pjesë
Z. Oscar Bottura – 1 kuotë – 50% me vlere 100.000 (njëqind mijë lekë)
dhe
Z. Mareglen Tomori – 1 kuotë – 50% me vlere 100.000 (njëqind mijë lekë)

NENI 9
Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10
Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.
Administratoret e shoqërisë do të jene **Z. Oscar Bottura dhe Z. Mareglen Tomori**

NENI 11
Sekreti tregtar


Ortaku, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë “ADVANCED GREEN INDUSTRY PARTNERS CORPORATION” SH.P.K përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

NENI 12

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES

Oscar Bottura

Oscar Bottura 

Mareglan Tomori

Mareglan Tomori 